IKTK
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore

GJURMA MUJORE

Tetor 2026

61-vjetori i themelimit të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore

Bursa Mesdhetare e Turizmit Arkeologjik BMTA 2026; Paestum, Itali

Matje gjeofizike në Trojas, Belsh

Vijon dokumentimi dhe studimi i mozaikëve në Apoloni

Inspektim në terren, Kalaja e Kaninës

Restaurim, Xhamia e Muradies, Vlorë

Restaurimi i Manastirit të Shën Julitës dhe Qirikut në Dhuvjan, Gjirokastër

Inspektim në terren në Kishën e Shën Kollit, Saraqinisht

Botimi nr. 10

IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

61-vjetori i themelimit të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore

Gjatë këtij muaji, përkujtuam 61-vjetorin e krijimit të Institutit të Monumenteve të Kulturës, themeluar në Tiranë në vitin 1965,një moment të rëndësishëm në historinë e studimit, dokumentimit, restaurimit dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore në Shqipëri.

Përgjatë më shumë se gjashtë dekadave, institucioni ka kontribuar në njohjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore përmes kërkimit shkencor, dokumentimit, ndërhyrjeve të konservimit e restaurimit dhe botimeve studimore.

Ky përvjetor ishte një mundësi për të shprehur mirënjohjen ndaj brezave të specialistëve dhe studiuesve që kanë dhënë kontributin e tyre ndër vite.

Sot, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore vijon këtë rrugëtim, duke u mbështetur në përvojën e krijuar dhe duke përcjellë më tej dijen, përkushtimin dhe përgjegjësinë për ruajtjen e trashëgimisë kulturore.





IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Bursa Mesdhetare e Turizmit Arkeologjik 2026
Delegacioni shqiptar në Parkun Arkeologjik të Pompeit

Në kuadër të pjesëmarrjes së Shqipërisë në Bursën Mesdhetare të Turizmit Arkeologjik (BMTA 2026), përfaqësues të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, Parqeve dhe Siteve Arkeologjike si dhe Institutit të Arkeologjisë, zhvilluan një vizitë pune në Parkun Arkeologjik të Pompeit, me organizimin e Agjencisë Italiane për Bashkëpunim për Zhvillim (AICS Tirana).

Gjatë vizitës u shkëmbyen përvoja mbi administrimin, konservimin, kërkimin arkeologjik dhe menaxhimin e vizitorëve, me fokus te modeli i qëndrueshmërisë financiare dhe riinvestimi i të ardhurave në ruajtjen dhe zhvillimin e parkut.







IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Vijon prezantimi i trashëgimisë arkeologjike shqiptare në BMTA 2026

Në vijim të pjesëmarrjes në Bursën Mesdhetare të Turizmit Arkeologjik (BMTA 2026), në Paestum të Italisë, Shqipëria vijoi promovimin e pasurive të saj arkeologjike dhe potencialit të turizmit kulturor. Në hapësirën ekspozuese shqiptare u prezantuan Parku Kombëtar i Butrintit, në bashkëpunim me Fondacionin për Menaxhimin e Butrintit, si dhe Parqet Arkeologjike të Bylisit dhe Antigonesë, me mbështetjen e Agjencisë Italiane për Bashkëpunim për Zhvillim (AICS).

Gjithashtu, përfaqësuesit shqiptarë ndanë përvojën dhe vizionin e vendit në panelin ndërkombëtar “Cultural Heritage and Cooperation: Partnerships for Shared Development in the Framework of the Pact for the Mediterranean”, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të nivelit të lartë nga Italia, Komisioni Evropian, Egjipti dhe Jordania. Ky takim shërbeu si një mundësi për të forcuar bashkëpunimin dhe partneritetet ndërkombëtare në fushën e trashëgimisë kulturore.



IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.









IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Matje gjeofizike në Trojas, Belsh.

Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, në bashkëpunim me Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave të Universitetit Politeknik të Tiranës, ka kryer matje gjeofizike në Trojas, pranë Belshit, në vijim të evidentimit të rrënojave arkeologjike të identifikuara më herët nga specialistët e IKTK-së.

Përmes identifikimit të anomalive gjeofizike, synohet përcaktimi më i saktë i zonave me potencial arkeologjik, duke krijuar bazën për dokumentimin dhe studimin e mëtejshëm të strukturave të mundshme të ruajtura nën sipërfaqe.



IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.







IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Vijon dokumentimi dhe studimi i mozaikëve në Apoloni

Projekti “Korpusi i Mozaikëve të Shqipërisë”, një bashkëpunim mes Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK) dhe Qendrës Kombëtare për Kërkime Shkencore (CNRS), Paris, Francë, me mbështetjen e Parkut Arkeologjik Kombëtar Apoloni, vijon punën në mozaikët e Banesës Romake D, e njohur edhe si Vila e Athinases.

Aktivitetet në terren përfshijnë pastrimin sipërfaqësor, rilevimin ortografik me dron, dokumentimin dhe përshkrimin e detajuar të mozaikëve, si dhe studimin e teknikave të realizimit dhe materialeve të përdorura.

Në varësi të gjendjes së ruajtjes, parashikohen edhe ndërhyrje konservuese dhe konsoliduese aty ku është e nevojshme, krahas dokumentimit të detajeve që ndihmojnë në njohjen dhe studimin e mëtejshëm të këtyre dëshmive të trashëgimisë arkeologjike.





IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.









IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Inspektim në terren, Kalaja e Kaninës

Specialistët e IKTK zhvilluan një inspektim në terren në Kalanë e Kaninës, me qëllim evidentimin e gjendjes aktuale të monumentit dhe vlerësimin e ndërhyrjeve të realizuara deri më tani.

Gjatë inspektimit u konstatua gjendja e strukturave historike, duke u kushtuar vëmendje ruajtjes së vlerave arkitektonike dhe autenticitetit të monumentit.

Monitorimi në terren mbetet një proces i rëndësishëm për ndjekjen e gjendjes së monumenteve dhe garantimin e mbrojtjes së trashëgimisë sonë kulturore.



IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.







IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Restaurim, Xhamia e Muradies, Vlorë

Në kuadër të masave për ruajtjen, mbrojtjen dhe restaurimin e Xhamisë së Muradies në Vlorë, monument kulture i kategorisë së parë, u zhvillua një inspektim në terren nga përfaqësues të IKTK-së, DRTK Vlorë, TIKA-s dhe kompanive zbatuese turke e shqiptare.

Pas përfundimit të fazës së parë të punimeve, që përfshiu zbulimin e strukturës së çatisë, verifikimin e elementeve të minares dhe heqjen e suvasë së degraduar në ambientet e brendshme, gjatë inspektimit u kryen matje dhe vlerësime teknike të strukturës së monumentit. Të dhënat e mbledhura do të shërbejnë për hartimin e studimit statik dhe përcaktimin e ndërhyrjeve të nevojshme restauruese e përforcuese.

Ky proces synon garantimin e qëndrueshmërisë së monumentit, duke ruajtur vlerat e tij historike, arkitektonike dhe autenticitetin. IKTK vijon angazhimin, në bashkëpunim me institucionet dhe partnerët, për mbrojtjen dhe restaurimin e kësaj pasurie të rëndësishme kulturore.



IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.









IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Restaurimi i Manastirit të Shën Julitës dhe Qirikut, Dhuvjan, Gjirokastër

Manastiri i Shën Julitës dhe Qirikut në Dhuvjan të Dropullit po i nënshtrohet restaurimit, me mbështetjen e World Monuments Fund, në kuadër të fazës aktuale të projektit.

Krahas ndërhyrjeve në monument, projekti përfshin edhe vendosjen e sinjalistikës përgjatë shtigjeve që lidhin monumentet e zonës, duke kontribuar në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe në zhvillimin e turizmit kulturor në Dropull.

Projekti zbatohet nga Cultural Heritage Without Borders, në bashkëpunim me IKTK, DRTK Gjirokastër, Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Bashkinë Dropull dhe komunitetin lokal.

Ky bashkëpunim ndërinstitucional dhe komunitar po kontribuon në ruajtjen dhe rijetëzimin e trashëgimisë fetare të zonës, duke krijuar njëkohësisht mundësi të reja për zhvillimin ekonomik dhe social të komunitetit.





IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.









IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Inspektim në terren në Kishën e Shën Kollit, Saraqinisht, Gjirokastër

Specialistët e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore zhvilluan një inspektim në terren në Kishën e Shën Kollit, në fshatin Saraqinisht, Gjirokastër, me qëllim vlerësimin e gjendjes së monumentit dhe evidentimin e problematikave që kërkojnë vëmendje.

Vëmendje e veçantë iu kushtua edhe pikturës murale, si një prej elementeve me vlera të rëndësishme artistike dhe historike të kishës, për të cilën nevojiten masa konservuese dhe restauruese për ruajtjen e shtresave të pikturuara dhe parandalimin e dëmtimeve të mëtejshme.

Inspektimi synon të kontribuojë në përcaktimin e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe ruajtjen e këtij monumenti me vlera të veçanta të trashëgimisë kulturore.











IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.